



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 444/ Prot.

Elbasan më 07 . 4 . 2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.35 datë 29.03.2024 “Për miratimin e listës shtesë të familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2024”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda Perriu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.03.04.2024

Nr. 1626/prot
16

Nr.35 dt.29.03.2024

**“PER MIRATIMIN E LISTES SHTESE TE FAMILJEVE QE PLOTESOJNE KUSHTET
PER PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TE QIRASE PER VITIN 2024”**

Bazuar ne Ligjin nr.22/2018, “Per strehimin social”, Ligji 139/2015 “Per veteqeverisjen Vendore”, VKM Nr.459, date 03.07.2019 “ Rregulla per administrimin e kerkesave te njesive te veteqeverisjes vendore per fonde nga buxheti i shtetit per subvencionimin e qirase ose uzufuktit, menyren e financimit te subvencionit, monitorimin dhe bashkepunimin ndermjet njesive te veteqeverisjes vendore dhe ministrise pergjegjese per strehimin “, V.K.B nr.112, date 30.11.2023 “Mbi miratimin e sistemit te pikezimit per projektin social “Bonusi Strehimit”, Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 29.03.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I :

1. Te miratoje listen shtese te familjeve aplikuese per programin e subvencionimit te qirase.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillim Territorit (Zyra e Sherbimeve dhe Strehimit) si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

RELACION

**“PER MIRATIMIN E LISTES SHITESSE TE FAMILJEVE QE PLOTESOJNE
KUSHTET PER PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TE QIRASE PER VITIN 2024”**

Bazuar ne Ligjin nr.22/2018, “Per strehimin social”, Ligji 139/2015 “Per veteqeverisjen Vendore”, VKM Nr.459, date 03.07.2019 “ Rregulla per administrimin e kerkesave te njesive te veteqeverisjes vendore per fonde nga buxheti i shtetit per subvencionimin e qirase ose uzufuktit, menyren e financimit te subvencionit, monitorimin dhe bashkepunimin ndermjet njesive te veteqeverisjes vendore dhe ministrise pergjegjese per strehimin “, V.K.B nr.112, date 30.11.2024 “Mbi miratimin e sistemit te pikezimit per projektin social “Bonusi Strehimit”, u mor ne shqyrtim aplikimi i paraqitur prane zyres se strehimit per programin e kompensimit te qirase.

Aplikanti Vangjel Kovaci i perket kategorive qe favorizohen nga ligji i strehimit per perfitimin e kompensimit te qirase, pasi ky individ eshte I moshuar, I braktisur nga familja dhe nuk perfiton pension.

Per kete individ kerkohet qe kompesimi I bonusit te qirase te financohet 100% nga bashkia.

Nr.	Emer/Atesi/Mbiemer	Perberje familjare	Kategoria (sipas pikes 45, e nenit 2, te ligjit 22/2018)	Aftesia perballuese sipas nenit 3 te ligjit	Qiraja e perballueshme	subvencioni ne muaj	subvencioni ne muaj qe mbulohet nga bashkia	Subvencioni per pjesen e mbetur te vitit qe mbulohet nga bashkia
1	VANGJEL KOVACI	1	familje pa te ardhura	0%	0	8000	8000	72000

Propozojme miratimin e listes nga Keshilli Bashkiak.

Zyra e Strehimit
D.HASULA

